



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA BERAT  
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL

RELACION

**MBI PËRDORIMIN E FONDIT TE SHËRBIMIT SOCIAL, MBËSHTETJE  
FINANCIARE PËR PËRBALLIMIN E SHPENZIMEVE NË RASTE TË VEÇANTA  
ZNJ.SUZANA XHAFA**

Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtorine e Financës, bazuar në kërkesen e bërë nga Znj.Suzana Xhafa me Nr.9927 Prot datë 19.09.2019 mbështetur në ligjin nr.139/2016 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8, neni 24, /1, neni 40/6 , neni 54, neni 64/c ; ligjin 68/2017 date 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 4 pika 4; ligjin nr.57/2019, “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, VKB nr.140 datë 07.12.2018 “Per miratimin e buxhetit te vitit 2019 dhe PBA perfundimtare 2019-2021”.

**JU RELATOI:**

***Të nderuar Këshilltar !***

**znj. Suzana Hajdar Xhafa** është lindur më datë 13.06.1967, banuese në lagjen Nr.1, me numër **ID G 75613044 F**. Aktualisht jeton vetëm me djalin e saj Orgito, 11 (njëmbëdhjetë) vjec, pasi prej disa muajve bashkëshorti i saj ka humbur jetën prej sëmundjes kronike tumor malinj. Gjatë bisedës së drejtëpërdrejtë me znj. Suzana vlerësuam se gjendja e saj shëndetësore, sociale dhe ekonomike paraqitet shumë e vështirë. Pasi prej afër dy viteve është diagnostikuar me tumor malinj dhe është detyruar të përballet jo vetëm me problemin shëndetësorë të bashkëshortit por edhe gjendjen e saj të rënduar shëndetësore.

Djali, Orgito, sipas nënës paraqet probleme të shëndetit mendor të cilat kanë krijuar herë pas here vështirësi në komunikimin dhe sjelljen e tij. Pas diagnostikimit të saj, znj.Suzana përballet me një situatë tepër të vështirë shëndetësore, ekonomike dhe sociale. Për këtë arsye ajo ka vendosur të zhvendoset së bashku me djalin, në qytetin e Durrësit, tek motra e saj, me qëllim reduktimin e kostove për të shkuar në ndjekjen e terapive dhe mundësinë e kujdesit të të afërmeve



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

për të dhe djalin. Znj.Suzana e ka të pa mundur të ndjeki përherë terapitë për shkak të ekonomisë të përdhjetirë dhe problematikave sociale.

E ardhura e vetme që ka familja janë pagesa e aftësisë së kufizuar në masë 10 653(dhjetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tre) lekë/muaj. Të ardhura të cilat nuk llogariten pasi vijnë nga aftësia e kufizuar.

*Bashkëngjitur relacionit keni dokumentacionin dhe diagnozën e Znj. Suzana Xhafa.*

PRGJ/SEK  
Piro XHEBLATI

DREJTORI I SHËRBIMIT SOCIAL  
Juvina QEVANI

Znj. Kowoml

24.09.2019

### KËRKESE PËR INFORMACION

<b>Emër Mbiemër:</b> Znj.Suzana Xhafa	<b>Adresa postare: Berat Lagjja Barikade.</b> <b>ID :G75613044F</b> <b>Tel:0692183607</b>	<b>Data:</b> 19.09.2019 <b>Nr.prot</b> 9927 <b>Nënshkrimi:</b>
--	---	--

(dërgimi i kërkesës elektronikisht kërkon emër, mbiemër, nënshkrim dhe dokument identifikimi të skanuar)

#### Të tjera të dhëna

Znj.Suzana Xhafa banor ne Berat lagjja Barikade. Znj.Suzana prej nje viti eshte diagnostikuar me tumor malinje . Kerkon ndihme finciare nga Bashkia per ta ndihmuar sepse zonja nuk ka te ardhura per te perballuar shpenzimet e ilaceve dhe kimioterapin. Bashkalidhur me kerkesen eshte dhe kerkesa e zonjes Suzana Xhafa.

Forma që kërkohet informacioni / dokumentacioni: \_\_\_\_\_

#### Vetëm për përdorim zyrtar

Data e marrjes: /09 /2019

Numri rendor i kërkesës: \_\_\_\_\_

Punuar : Nga Dionisa Thuqi

- ❖ Adresa dhe kontaktet mund të gjenden nëpërmjet konsultimit pa pagesë të informacionit në mjediset e autoritetit publik, nëpërmjet portalit unik qeveritar e-albania.al apo, kur është rasti, nëpërmjet faqes zyrtare të autoritetit publik në internet.
- ❖ Drejtoni kërkesën tuaj, Koordinatorit për të drejtën e informimit, të institucionit që mban informacionin e kërkuar. Kontaktet e tij, janë të publikuara në faqen zyrtare të institucionit.
- ❖ Kur ju mendoni se ju kanë mohuar ndonjë prej të drejtave tuaja në bazë ligjit, keni të drejtë të ankoheni tek Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Për ndjekje,

Znj. Avarani



drejtuar kryetarit të bashkisë Berat: -

- Z. Ennir Dema,

Unë e nënshkruara Znj. Suzana Xhafa, Banore e lagj. BARRIKADË BERAT, kam njerëz për ndihmë pasi jeta ime ndryshoi kryekëput që nga 9. IV. 2018. Në këtë datë më ka vdekur bashkëshorti me kancer në mushkri. Mbas tij jam diagnostikuar edhe vetë me kancer në gjoks. Vjet në 25. VI. 2018 jam operuar, kam hequr gjoksin. Kam bërë radioterapi, kimioterapi, madje deri në fund të vitit 2019, do të vazhdoj me kimioterapi. Gjate kësaj periudhe nënshkruar jam bërë puthur banore e spitalit, duke bërë gati çdo ditë, një herë në dy javë, ose e padishkruarherë një herë në 21 ditë analiza, shamerheka etj. etj. Në përberjen familjare jam unë dhe djali 11 vjeçar, i cili ka njerëz për udhëtim, veshmbledhje, bujdes shëndetësor etj. Trajtohem me ndihmë sociale.

Gjyë që tregon, që as udhëtimet për në spital nuk i shlyejn dot. Për të mos folur fare për kurimin tim. Përndryshe jetoj me frikë e vdekjes çdo ditë, por jetoj edhe me frikë se mos i të kurat pëppjsem.

Nuk kam arsyë të ardhur tjetër. Kam shumë, shumë për të shkuar në edhe nga ditë për të punuar dhe jetoj te motra e cila bujdeset për unë dhe djalin. Por synimi i kësaj kërkesë është: -

- Kërkoj një ndihmë financiare brenda mundësive të bashkisë të shtesë kurimin tim.

Me respekt dhe besim të plotë që kjo kërkesë do të merret në konsideratë, nga Znj. Suzana Xhafa.

(Suzana Xhafa)

G75613044F

0693183607

Berat më 18/09/2019/